



# KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

Tiranë, më 17 Korrik 2023

## KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI KOMPANI AUDITUESE

**Data e kërkesës: 17 Korrik 2023**

**Data e përfundimit: 23 Korrik 2023**

**Objekti i kërkesës: Realizimi i procesit të regjistrimit të furnitorëve, faturave të blerjeve dhe rregullimin e pagesave të bëra nga arka ose banka për faturat e këtyre furnitorëve, sipas legjislacionit në fuqi, për periudhën 01.01.2022 -31.08.2023**

**Autoriteti Kontraktues: Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

### Rreth Autoritetit Kontraktues:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë jofitimprurëse, në formën e shoqatës me anëtarësi. Është regjistruar fillimisht pranë Ministrisë së Drejtësisë, me urdhrin nr. 17/1 dhe më pas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas ligjit “Për organizatat jofitimprurëse” me vendimin nr.2/1, datë 19.07.2002.

### Termat e Referencës të shërbimit që kërkohet të ofrohet nga kompania audituese:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit kërkon të kontraktojë një Kompani Auditimi për realizimin e procesit të regjistrimit të furnitorëve, faturave të blerjeve dhe rregullimin e pagesave të bëra nga arka ose banka për faturat e këtyre furnitorëve, sipas legjislacionit në fuqi, për periudhën 01.01.2022 - 31.08.2023.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit nuk është subjekt i TVSH-së.

Kompania audituese e përzgjedhur, bazuar në kërkesat dhe informacionin e dhënë nga stafi përgjegjës i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH-së), do të angazhohet për të kryer rezultatet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Regjistrimi i Shitësit/ve: Regjistrimi i të gjithë shitësve në programin tonë financiar (*Alpha web*), nga të cilët kemi blerë produkte apo shërbime, për periudhën 01.01.2022 - 31.08.2023.

2. Regjistrimi i Blerjeve: Regjistrimi i të gjitha faturave të blerjeve në programin tonë financiar (*Alpha web*), bazuar në portalin e vetë-kujdesit për blerjet nga subjektet e biznesit dhe faturat e blerjeve nga individë me kontrata shërbimi, për periudhën 01.01.2022 - 31.08.2023.

3. Regjistrimi i Pagesave: Regjistrimi i të gjitha marrëveshjeve të pagese për të gjitha blerjet në programin tonë financiar (*Alpha web*), në vend të klasës së kontabilitetit, pagesa duhet të lidhet me faturën që paguhet, për periudhën 01.01.2022 - 31.08.2023.



## KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

---

4. Regjistrimet në librin kryesor (*General Ledger Entries*): Të kryhen rakordime në regjistrimin në librin kryesor në programin tonë financiar (*Alpha web*) për shitësit, blerjet, pagesat përkatëse që ndikojnë në këto transaksione për periudhën 01.01.2022 – 31.08.2023.

Shërbimi i kërkuar do të realizohet nga Kompania audituese fituese, përgjatë muajit Shtator 2023, në përputhje me komunikimet e përcjella nga ana e stafit përgjegjës të KShH-së.

### **Kriteret që duhet të përmbushë kompania audituese:**

Në përzgjedhjen e aplikantit fitues, Komiteti Shqiptar i Helsinkit do të mbajë në konsideratë kriteret vijuese për të cilat duhet depozituar dokumentacion mbështetës:

- a) Liçencën e auditimit dhe përvojën së paku 5 vite në këtë fushë (Licencë dhe CV e kompanisë përfshirë kualifikimet përkatëse);

Për të aplikuar, dërgoni ofertën tuaj financiare dhe dokumentacionin shoqërues, deri më datë 23 Korrik 2023, në adresën [office@ahc.org.al](mailto:office@ahc.org.al)